



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 125, Datë 24.06.2025

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.06.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1497/10 prot., datë 16.06.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e Kërkesës për Licencim

- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. paraqiti më 10.04.2025 kërkesën për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Fillimi i Procedurës së Licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 84, datë 24.04.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 25.04.2025 dhe 26.04.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit dhe deri më datë 05.05.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë patur të tilla.

3. Dorëzimi i Dokumentacionit dhe Kërkesës për shtyrje të afateve

- Më datë 05.05.2025, shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. dorëzoi pranë ERE-s, përmes e-maileve të protokolluara dhe në formë fizike, dokumentacion plotësues lidhur me aplikimin për licencim.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ERE dhe korrespondencës me shoqërinë kjo e fundit me datë 19.05.2025, ndër të tjera kërkoi disa ditë shtesë për dorëzimin e dokumentacionit të mbështetjes financiare, me argumentin se ishte në proces sigurimi të tij.

4. Zgjatja e Vendimmarrjes së Bordit

- Në vijim të kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k., e paraqitur me e-mailin e datës 15.05.2025 dhe protokolluar në ERE me nr. 1497/6 prot., datë 19.05.2025, për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të mbështetjes financiare, me vendimin nr. 105, datë 23.05.2025, bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për licencim.
- Në vijim të njoftimit të këtij vendimi, përmes shkresës nr. 1497/9 prot., datë 03.06.2025, rezulton se shoqëria ka dorëzuar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit, përmes shkresës së protokolluar me nr. 1497/8 prot., datë 08.06.2025, nga shqyrtimi i të cilit mbetet ende për t’u sqaruar çështja e strukturës organizative të kompanisë dhe mbështetja financiare.

5. Shtyrja e Afatit të Vendimmarrjes

- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të përditësojë informacionin/dokumentacionin në lidhje me strukturën organizative dhe mbështetjen financiare.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria duhet të përditësojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI